



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**KORNIZA E
VLERËSIMIT
TË CILËSISË SË
SHKOLLËS**

Maj, 2020



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Ky dokument u përgatit nga:

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Teuta Çobaj

Eniana Veli

Majlinda Ucaj

Shemsi Muça

Irida Sina

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës u mundësua edhe falë konsulencës së z. Tony Richardson, ekspert ndërkombëtar për lidërsipin, edukimin, teknologjinë, vlerësimin dhe inspektimin.

Redaktor gjuhësor: Zija Kurti

PËRMBAJTJA

HYRJE

I. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

I.1. Parimet kryesore të sigurimit të cilësisë dhe referenca ligjore.....5

II. KONCEPTET THEMELORE TË KORNIZËS

II.1. Sistemi i vlerësimit të cilësisë së shkollës.....8

II.2. Parimet kryesore të vlerësuesve të shkollës.....10

II.3. Fushat e cilësisë11

II.4. Kriteret e cilësisë14

II.5. Treguesit e cilësisë.....17

II.6. Shkallët e vlerësimit.....22

BAZA LIGJORE.....24

BIBLIOGRAFIA.....24

Nuk ka ndonjë model për sukses. Secili sistem edukativ mund të arrijë rezultate duke kombinuar politika mbështetur në evidenca dhe duke përshtatur procesin e implementimit me kontekstin dhe sfidat konkrete.¹

I. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës është *çelësi* për ndërtimin e sistemeve të drejta shkollore. Ajo përcakton pritshmëritë themelore për çdo shkollë që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. Korniza e Vlerësimit është dokumenti referues për sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar, e cila standardizon procesin e vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm të shkollës.

Hartimi i këtij dokumenti është i domosdoshëm dhe i nevojshëm për përmirësimin e procesit të vlerësimit të cilësisë së shkollës, si një mekanizëm i përgjegjshëm dhe llogaridhënës, në zbatim të reformave arsimore dhe të kornizës së re kurrikulare në vendin tonë.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës përcakton: fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e cilësisë, shkallët e vlerësimit dhe trendin e rivlerësimit.

Korniza për Vlerësimin e Cilësisë së Shkollës është mjet i rëndësishëm, në funksion të përmbushjes së detyrave të institucioneve vlerësuese/inspektuese, drejtorëve të shkollave, mësuesve dhe palëve të interesuara në procesin e vlerësimit të shkollës. Gjithashtu, ajo do të ndihmojë prindërit dhe aktorët e tjerë të kuptojnë gjykimet vlerësuese në raportet e vlerësimit.

Gjuha e përbashkët e vlerësimit të cilësisë së shkollës e dhënë në këtë kornizë, do të lehtësojë dialogun midis mësuesve, profesionistëve/ekspertëve të arsimit, prindërve, nxënësve, komuniteteve shkollore dhe më gjerë për cilësinë e shkollave tona.

I.1. Parimet kryesore të sigurimit të cilësisë dhe referenca ligjore

Ligji i arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë garanton, që sistemi arsimor të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera të një shoqërie demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Qëllimet e përgjithshme të arsimit shtjellohen dhe konkretizohen më tej, në rezultatet e pritshme të të nxënësve, në përmbajtjet mësimore dhe në kulturën e përditshme të shkollës. Realizimi i tyre është detyrë e të gjitha institucioneve arsimore parauniversitare dhe aktorëve të tjerë gjatë procesit të arsimit.

¹ Beatriz.pont@oecd.org education and policy today, presentation.

Nga ana tjetër, Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar është dokumenti themelor, që siguron funksionimin e sistemit, nëpërmjet përshkrimit të orientimeve dhe të udhëzimeve kryesore, për zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar. Funksionimi i mirë i këtij sistemi arrihet nëpërmjet respektimit të parimeve të përgjithshme të kësaj kornize, të cilat janë: konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash; gjithëpërfshirja; baraspesha dhe integrimi; vijimësia; bashkëpunimi dhe partneriteti; autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, si dhe përgjegjshmëria. Këto parime janë referenca kryesore për hartimin e të gjitha dokumenteve kurrikulare.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës është ndërtuar pikërisht, mbi ndërveprimin mes këtyre parimeve dhe fushave të cilësisë së shkollës. Parimet e kurrikulës përbëjnë themelin e sistemit të vlerave të Kornizës për Vlerësimin e Cilësisë së Shkollës, ndërsa fushat e cilësisë i japin strukturën dhe ndërlidhjen vertikale, për vlerësimin e gjendjes dhe për planifikimin e përmirësimit.

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës është hartuar edhe në përputhje me parimet kryesore² të zhvillimit të politikave të sigurimit të cilësisë, të referuara nga Komisioni Evropian.

Tabela 1: Parimet e ET-së 2020

<p>Koherenca</p>	<p>Sistemi arsimor shqiptar dhe vetë shkolla kanë ndryshuar thellësisht, prandaj, Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës duhet të arrijë ekuilibrin dhe koherencën e duhur, duke parashikuar mekanizma vlerësimi, të cilët përmbushin kërkesat e zhvillimeve bashkëkohore. Kurrikula e re, standardet profesionale të drejtorit, standardet profesionale të mësuesit, nivelet e arritjeve të nxënësve dhe ndryshimi i akteve ligjore e nënligjore, kërkojnë një proces vlerësimi koherent me pritshmëritë në nivel shkolle dhe sistemi.</p>
<p>Bashkësia profesionale</p>	<p>Politikat e sigurimit të cilësisë mbështetin komunitetet e të mësuarit profesional, në shkëmbimin e përvojave pozitive, njohjen dhe përdorimin e risive për përmirësimin e shkollës dhe sistemit, me të vetmin qëllim: mundësi më të mira edukimi për të gjithë nxënësit. Ngritja dhe funksionimi i rrjeteve profesionale për mësuesit dhe drejtorët, ka qenë në fokusin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre.</p>
<p>Besimi, llogaridhënia dhe</p>	<p>Besimi dhe respekti midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës është themelor, për vlerësimin efektiv dhe përmirësimin e shkollës. Llogaridhënia krijon dhe mbështet besimin, për të gjithë grupet</p>

² Working Groups European Commission, Guiding principles for policy development on quality assurance in school education, Quality assurance for school development, produced by the ET 2020 (Parimet e përgjithshme të zhvillimit të politikave të sigurimit të cilësisë).

Transparenca	e interesit dhe aktorët e tjerë në sistem, nëpërmjet të dhënave të qarta dhe të sakta. Një ndër ndryshimet e viteve të fundit në sistem që lidhet me llogaridhënien në nivel shkolle, përfaqësohet nga “Karta e Performancës së Shkollës”, e cila informon për cilësinë e shkollës në raport me veten dhe shkollat e tjera në nivel lokal dhe rajonal.
Dialog profesionistësh	Qasja e sigurimit të cilësisë duhet të mbështesë të njëjtën gjuhë dhe kuptueshmëri mes aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e vlerësimit. Qëllimi final i vlerësimit është të mbështesë përmirësimin e shkollës. Pikërisht për këtë, dialogu mes profesionistësh krijon mundësi që të ndahen përvojat pozitive, pikat që kanë nevojë për ndryshim në shkollë dhe risitë bashkëkohore ndërmjet inspektorëve dhe aktorëve të shkollës.
Krijimi i networkut	Krijimi i lidhjeve të shkollës me komunitetin sjell një mbështetje të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo mundëson ndërtimin e kapaciteteve sociale dhe kulturore që japin energji të reja brenda sistemit të shkollave. Në kushtet e epokës digjitale, kjo kthehet në një mundësi të prekshme edhe nga shkollat tona.
Ndërtimi i kapaciteteve për të dhënat	Investimi në ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve kyç për gjenerimin, interpretimin dhe përdorimin e të dhënave, është thelbësor për vlerësimin e cilësisë së shkollës në veçanti dhe sistemit në tërësi.
Mbështetja inovative	Drejtuësit e shkollave duhet të ndërtojnë e ngrenë kapacitetet profesionale, duke u mbështetur në idetë inovative të mësuesve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit për një shkollë të hapur.
Ekulibrimi	Të dhënat sasiore dhe cilësore janë të nevojshme për një kuptim të balancuar të zhvillimit të shkollës dhe përparimit të nxënësve. Këto të dhëna duhet të japin informacionin e nevojshëm për të mbështetur vendimmarrjen, si në shkolla, ashtu edhe në sistemin arsimor në tërësi. Të dhënat e vlerësimit të jashtëm, vlerësimit të brendshëm (konteksti i shkollës, plani afatmesëm, plani vjetor, planet zhvillimore, vlerësimi i drejtorit nga eprori i ZVA-së, vlerësimet e mësuesve, vlerësimi i infrastrukturës së shkollës etj.), si dhe renditja e shkollës sipas Kartës së Performancës në nivel lokal dhe rajonal etj., shërbejnë për të analizuar pikat e forta dhe të dobëta të shkollës, me qëllim hartimin e planifikimeve strategjike për përmirësimin e saj.

II. KONCEPTET THEMELORE TË KORNIZËS


II.1. Sistemi i vlerësimit të cilësisë së shkollës

Prindërit, shoqëria dhe politika kanë kërkuar dhe vazhdimisht kërkojnë, që shkolla të vlerësohet, për të parë se si i realizon detyrat e saj. Sistemi i vlerësimit (vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm) ka të bëjë me cilësinë. Ai është proces vlerësimi i vazhdueshëm i inputeve³, i proceseve dhe i rezultateve të shkollës, në mënyrë që të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta dhe të rekomandohen veprimet që do të ndërmerren, për të arritur rezultatet e pritshme. Sot, theksohet që sistemi i vlerësimit të cilësisë së shkollës, nuk duhet të jetë si përfundim në vetvete, por duhet parë si mjet i rëndësishëm, i orientuar drejt përmirësimit të performancës së shkollës.

Vlerësim i jashtëm i shkollës realizohet nga institucionet vlerësuese, nëpërmjet vlerësuesve/inspektorëve profesionistë, ndërsa vlerësimi i brendshëm realizohet nga vetë shkolla, me përfshirjen e të gjithë aktorëve të saj, kurdoherë si veprimtari e mirëplanifikuar.

Vlerësimi i jashtëm dhe vlerësimi i brendshëm nuk kanë vlerë, nëse nuk çojnë në përmirësimin e praktikave mësimore dhe në motivimin e nxënësve për arritje më të larta. Si rrjedhojë, duhet që vlerësimi i jashtëm dhe vlerësimi i brendshëm të kenë funksion zhvillimor, që së bashku, të vënë theksin mbi rëndësinë e përdorimit të praktikave konstruktiviste, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuara nga mësuesi, në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe të vlerësimit të rezultateve të nxënësve. Për këtë arsye, është e rëndësishme që vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm i shkollës të realizohet, duke përdorur të njëjtat elemente të standardizuara në këtë kornizë, përkatësisht: fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e cilësisë dhe shkallët e vlerësimit. Nga ana tjetër, Karta e Performancës ndihmon procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës, nëpërmjet të dhënave krahasuese të shkollës ndër vite në nivel lokal dhe rajonal.

Grafiku 1: Sistemi i vlerësimit të shkollës



³ Fjala “input” nënkupton statistika dhe tregues hyrës për nxënësit, mësuesit dhe infrastrukturën e shkollës.

Vlerësimi, si sistem, siguron edhe dhënien e informacioneve të dobishme për prindërit, nxënësit, punëdhënësit, hartuesit e politikave në të gjitha nivelet, për të siguruar përfshirjen e tyre në vendimmarrje, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga shkolla.

Vlerësimi i jashtëm i shkollës

Duke filluar nga vitet '90, rishfaqet fuqishëm interesi mbarëbotëror për problemet e cilësisë arsimore dhe monitorimin e inspektimit të saj. Disa vende që e kishin “çmontuar” mbikëqyrjen, e ringritën përsëri, vende të tjera që nuk e kishin, e kanë ngritur atë. Ka disa arsye që qëndrojnë prapa këtij interesi në rritje ndaj inspektimit dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit arsimor.

Në shumë vende ka një perceptim, sipas të cilit, zhvillimi i shpejtë i arsimit ka sjellë ulje të cilësisë. Përmirësimi i tij është shndërruar në prioritetin kryesor të politikave, duke rritur dukshëm interesin e tyre për kontrollin e cilësisë. Nga ana tjetër, sindroma “vlera sipas parasë”, e përdorur në të gjithë sektorët e shoqërisë, ka prekur edhe sistemin arsimor. Duke qenë e lidhur me rritjen e kërkesës për përgjegjshmëri më të lartë në shërbimet publike, shoqëria kërkon mekanizma më të fortë kontrolli për shkollën. Ndërkaq, studime të ndryshme kanë treguar se cilësia vlerësuese është një nga arsyet themelore të rënies së cilësisë së shkollave. Kjo shpjegon edhe rritjen e interesit për procedura efektive të vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i jashtëm përshkruhet si vëzhgim dhe vlerësim i drejtpërdrejtë i mësuesve dhe/ose shkollave dhe zhvillohet paralelisht me “*rregullimin*” - miratimin e ligjeve, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar nga shkolla.

Vlerësimi i jashtëm i shkollës është i orientuar së fundmi, më shumë si një funksion vlerësues, këshillues, kontrollues dhe informues. Publikimi i vlerësimeve të jashtme është i rëndësishëm, pasi:

- informimi publik i cilësisë së shkollës është shembull i llogaridhënies dhe i transparencës;
- informimi i konsumatorëve të arsimit është shembull i llogaridhënies së bazuar në treg, duke inkurajuar prindërit që të ndikojnë në vendimmarrjet e shkollës;
- dhënia e informacioneve për shkollat është bazë për përmirësimin e saj në veçanti dhe sistemit arsimor në tërësi.

Vlerësimi i brendshëm i shkollës

Komisioni Evropian ka rekomanduar, që nga fillimi i viteve 2000, realizimin e vlerësimit të brendshëm në vendet evropiane. Sot, në 27 vende evropiane, vlerësimi i brendshëm i shkollës⁴ është i detyrueshëm. Gjithashtu, në botimin e SICI-t⁵, autori Adrian Gray, duke vlerësuar ecurinë e proceseve të inspektimit dhe vlerësimit të brendshëm, shkruan: “*Tashmë inspektoratet gradualisht kanë zhvilluar mënyra efektive për integrimin e vlerësimit të jashtëm me vlerësimin e brendshëm*”.

⁴ Shih: European Commission 2015, f. 10.

⁵ Shih: The Standing International Conference of Inspectores 2019, f. 148.

Edhe në Shqipëri, shkolla e ka të detyrueshëm realizimin e vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin të gjithë punonjësit arsimorë dhe organizmat e shkollës. “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, MASR, 2020, përcakton që vlerësimi i brendshëm të kryhet, mbështetur në udhëzuesin “Metodologjia për vlerësimin e brendshëm të shkollës”, ASCAP, 2020.

Shkolla në procesin e vlerësimit të brendshëm, duhet të jetë e aftë t’u përgjigjet pyetjeve:

- Sa mirë jemi duke punuar?
- Si mund të punojmë më mirë?

Vlerësimi i brendshëm i shkollës është një proces i ndërgjegjshëm, aktiv dhe bashkëpunues i të gjithë stafit, nëpërmjet të cilit, vetë shkolla ushtron përgjegjësinë e saj për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë. Shkolla në procesin e vlerësimit të brendshëm, dëshmon përgjegjësi, nëse demonstroi të dhëna bindëse për suksesin e saj, si dhe harton një plan pune të qartë, i cili tregon rrugët e përmirësimit.

Vlerësimi i brendshëm kontribuon kështu, në zhvillimin e planeve të shkollës, në identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të punonjësve dhe përcaktimin e nevojave organizative.

II.2. Parimet kryesore të vlerësuesve të shkollës

Sistemi i vlerësimit të shkollës, që përfshin vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës, është vendimtar në procesin e drejtimit dhe menaxhimit të saj, duke krijuar bashkëveprim mes faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në funksion të përmirësimit të shërbimeve arsimore. Vlerësimi efektiv i shkollës, kërkon nga vlerësuesit, të respektojnë parimet kryesore të vlerësimit, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Parimet kryesore të vlerësimit të cilësisë së shkollës

Transparenca	I gjithë stafi i shkollës, nxënësit dhe prindërit, kanë të drejtë të njihen me treguesit dhe metodat që vlerësohet shkolla, si dhe gjetjet dhe gjykimet për vlerësimin e cilësisë së saj. Gjykimet profesionale sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë për një zhvillim të qëndrueshëm.
Objektiviteti	Vlerësimi duhet të sigurojë një pasqyrë reale të kontekstit të shkollës dhe informacion të vlefshëm për proceset dhe rezultatet e zhvillimit të saj. Objektiviteti përshkruhet si një gjykim i paanshëm, që u mundëson vlerësuesve të kryejnë vlerësimin në mënyrë të tillë, që të kenë besim, për sa i përket produktit, dhe se nuk është bërë ndonjë kompromis, për sa i përket cilësisë. Objektiviteti kërkon që vlerësuesit, për problemet e vlerësimit, të mos varen në gjykimet e tyre nga eprorët dhe të tjerët.

Paanshmëria	Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e shkollës, pa u ndikuar nga karakteristikat e çdo shkolle, të tilla si: vendndodhja gjeografike, karakteristikat sociale dhe ekonomike, gjuha etj.
Besueshmëria	Gjykimet mbi rezultatet e shkollës duhet të bazohen në burime të ndryshme informacioni. Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse shkolla po zhvillohet dhe realizon përparësitë e saj. Integrimi i burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura, gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme, është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykime të qëndrueshme dhe të drejta për vlerësimin e shkollës.
Pavarësia	Pavarësia përcaktohet si të qenët i lirë nga kushtet që kërcënojnë objektivitetin ose të qenët objektiv. Është shumë e rëndësishme që vlerësuesit të jenë të pavarur, por gjithashtu, edhe të shihen nga të tjerët se janë të tillë. Pavarësia u lejon vlerësuesve që të japin gjykime të paanshme dhe të drejtpërdrejta, që janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e duhur të procesit të vlerësimit.
Pjesëmarrja	Të gjithë kanë të drejtë dhe detyrë, sipas përgjegjësive personale dhe profesionale, të marrin pjesë në krijimin e një pasqyre sa më të saktë për gjendjen reale dhe objektive në shkollë, njëkohësisht, të gjithë duhet të jenë pjesë e planifikimit dhe e zbatimit të masave përmirësuese në shkollë, në përputhje me gjetjet e vlerësimit.
Saktësia	Të dhënat/dëshmitë e mbledhura gjatë procesit të vlerësimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të shkollës duhet të jenë të sakta, të verifikueshme dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë, për të gjitha palët e interesuara.

II.3. Fushat e cilësisë

Korniza për Vlerësimin e Cilësisë së Shkollës ka përcaktuar katër fusha të cilësisë, të cilat janë shtyllat kryesore që lidhen drejtpërdrejt me gjithë veprimtarinë e shkollës dhe përcaktojnë performancën e saj në tërësi.

Përcaktimi i fushave të cilësisë është bazuar në aktet ligjore, qëllimet e arsimit parauniversitar, dokumentet kurrikulare, përvojat kombëtare dhe qasjet ndërkombëtare⁶.

⁶ Shih: Ofsted, The education inspection framework, 2019.

Grafiku 2: Fushat e cilësisë



Fusha 1. Drejtimi dhe menaxhimi

Shkolla është vendi ku bashkohen dhe integrohen të gjitha investimet, për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të nxënësve. Kjo është arsyeja pse shumë vende të botës po përqendrohen në organizimin dhe funksionimin e shkollës, ku roli i drejtorit ka dalë, si asnjëherë, në plan të parë. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në sistemin arsimor parauniversitar, si rezultat i reformave të ndërmarra, kërkojnë edhe ndryshimin e funksioneve të drejtorit të shkollës, në drejtues dhe menaxher të saj.

Drejtimi dhe menaxhimi i shkollës janë një binom thelbësor për të planifikuar, koordinuar dhe kontrolluar realizimin e vizionit të shkollës. Drejtimi dhe menaxhimi plotësojnë njëri-tjetrin, duke kombinuar liderin e organizatës shkollë dhe atë të menaxherit të burimeve njerëzore dhe financiare, të cilët së bashku sigurojnë sukses në zhvillimin e qëndrueshëm të shkollës.

“*Drejtim*” do të thotë të kesh një vizion të qartë mbi cilësinë e shërbimit që shkolla duhet të ofrojë dhe të jesh i aftë të motivosh e frymëzosh punonjësit mësimorë për të përbushur vizionin, kurse “*Menaxhim*” është organizimi i personelit të shkollës për të hartuar dhe realizuar synime dhe objektiva, që mundësojnë përbushjen e këtij vizioni.

Sot, më shumë se kurrë, drejtori i shkollës është forca lëvizëse, nxitëse dhe garantuese e realizimit të vizionit të shkollës, ku ai është përgjegjës për ofrimin e një shërbimi cilësor edukimi e arsimimi, transparent dhe llogaridhënës ndaj përfituesve të tij.

Fusha 2. Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënët

Shkolla, sot, synon ndërtimin dhe krijimin e dijes së nxënësit, për t’u përshtatur lehtë me kërkesat e standardet e reja të kohës, si qytetar i së ardhmes që kontribuon në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë, duke u përballur në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Shkolla është e drejtuar drejt një procesi të hapur, si një dukuri e cila lidhet me përmbajtjen e procesit të

mësimdhënies dhe të të nxënit, proces gjatë të cilit, nxënësit, mësuesit dhe prindërit janë njëherësh autorë dhe aktorë të tij.

Shkolla ndjek ritmet e rritjes individuale të nxënësve, duke emancipuar përmes përfshirjes së tyre në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit, të përfitimit dhe përpunimit të informacionit të ri, përdorimit të teknologjive të reja, si dhe njohjes dhe integritit me zhvillimet globale e më gjerë.

Mësimdhënia dhe të nxënit është një akt fleksibël, dinamik dhe bashkëveprues, mes mësuesit dhe nxënësve, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin vendime dhe role të përshtatshme. Mësimdhënia nuk mund të ndahet nga të nxënit dhe nuk duhet kuptuar si një përbërës formal, por duhet që të dyja bashkë, të sigurojnë rritjen e cilësisë të të nxënit për të gjithë nxënësit.

Mësimdhënia dhe të nxënit orientohet nga perspektiva dhe vështrimi drejt së ardhmes, për të ofruar mundësi më të mëdha për të gjithë nxënësit, për të zhvilluar tek ata kapacitetet, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme, për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike.

Fusha 3. Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës që kërkon planifikim të kujdesshëm dhe zbatim sistematik, të mbështetur në të dhëna reale dhe evidenca të sakta, që tregojnë nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit për lëndë/fushë në një shkallë të caktuar, të përcaktuara në kurrikulën bërthamë dhe në planet e programet mësimore.

Vlerësimi i nxënësve përshkon gjithë procesin mësimor dhe tregon dy anë të mësimdhënies: a) nevojat e nxënësve për të nxënë; b) arritjet e tyre. Qëllimi kryesor i vlerësimit është gjykimi i mësuesit mbi arritjet e nxënësit për kurrikulën e përvetësuar, si dhe mbështetjen e të nxënit dhe të përparimit të tij, duke synuar një kombinim të vlerësimit për të nxënë me vlerësimin e të nxënit.

Vlerësimi mbështet përmbushjen e kompetencave themelore, të rezultateve lëndore dhe formave të tjera të kësaj kurrikule, si projektet lëndore/ndërlëndore dhe aftësitë ndërkurrikulare.

Fusha 4. Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve

Mirëqenia e nxënësit në tërësi, është një ndjesi shumëdimensionale që përfshin aspekte të mirëqenies psikologjike, fizike, sociale dhe emocionale. Shkolla është mjedisi ku nxënësit kalojnë një pjesë të madhe të kohës, si e tillë ajo duhet të ofrojë një atmosferë mikpritëse dhe të krijojë mundësi shoqërizimi dhe përkatësie. Kushtet fizike të shkollës duhet të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor edukativ, si dhe konsolidimin e aftësive dhe kompetencave të nxënësit.

Mbështetja e nxënësit është përmbushja e nevojave dhe prirjeve të tij, çka nënkupton ofertën që paraqet shkolla në lëndët që zhvillon, si dhe larminë e veprimtarive ekstrakurrikulare, të cilat duhet të përkohet me veçoritë dhe interesat e nxënësit. Një tjetër komponent i rëndësishëm fokusohet te mbështetja emocionale dhe zhvillimi i potencialit të nxënësit, në mënyrë të veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta.

Një klimë miqësore dhe e shëndetshme ndikon në ndjesinë e aktorëve të angazhuar në shkollë, në motivimin e tyre për zhvillim në aspektin akademik dhe atë social. Një njohje e mirë e nxënësit nga shkolla bën që ai të marrë mbështetjen e duhur. Shkolla kujdeset që nxënësi të ndihet mirë, duke respektuar dallimet individuale. Shkolla siguron që nxënësit të trajtohen në mënyrë të drejtë, gjithëpërfshirëse, të vetëdijesohen për të drejtat e detyrat e tyre, si dhe të inkurajohen, të respektojnë dhe të kuptojnë pikëpamjet e të tjerëve.

II. 4. Kriteret e cilësisë

Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës përcakton *kriteret e cilësisë*, të cilat janë përcaktuar, bazuar në ndërveprimin mes fushave të cilësisë dhe parimeve të Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar. Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Shqipërisë, dhe i orientojnë ato për përmirësim të vazhdueshëm.

Secila fushë ka 6 kritere të cilësisë, të cilat burojnë nga gjashtë parimet e kurrikulës, duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim, në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës. Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës ka gjithsej 24 kritere të cilësisë.

Tabela 3: Kriteret e cilësisë

PARIMET E KURRIKULËS	Drejtimi dhe menaxhimi	Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënësve	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve	Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve
Kriteret e cilësisë				
Konceptim i gjerë dhe me bazë kompetencash	Drejtori udhëheq planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e përparësive të shkollës, në funksion të zhvillimit të kompetencave themelore, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit.	Mësuesit sigurojnë mundësi të barabarta arsimit për të gjithë nxënësit, duke realizuar një mësimdhënie dhe nxënie konstruktive, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuar, në situata dhe kontekste mësimore ose jetësore.	Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore, plotësojnë pritshmëritë e vendosura në kurrikulën bërthamë.	Shkolla siguron mjedise mësimore të sigurta, të përshtatshme dhe ftuese, në funksion të zotërimit të kompetencave themelore nga të gjithë nxënësit.
Gjithëpërfshirja	Drejtori siguron përfshirjen e gjithë aktorëve të interesuar në jetën e shkollës, për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të saj.	Mësuesit në planifikimin, zbatimin dhe përvetësimin e kurrikulës, bazohen në nevojat vetjake, stilet e të nxënësve dhe përvojat mësimore paraprake të të gjithë nxënësve, për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.	Shkolla siguron kushte, në mënyrë që nxënësit të nxënë dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet.	Shkolla siguron përfshirjen e të gjithë nxënësve në veprimtaritë mësimore-edukative për rritjen e mirëqenies.
Baraspesha dhe integrimi	Drejtori menaxhon situatat komplekse në mënyrë të barabartë, të drejtë e të paanshme, duke promovuar përgjegjësinë profesionale dhe llogaridhënien.	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke siguruar baraspeshën mes njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxënësve, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, për përvetësimin e saj nga të gjithë nxënësit.	Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve për fushat kurrikulare, ruajnë baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive qëndrimeve të secilës fushë të nxënësve, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.	Mësuesit sigurojnë strategji të mësimdhënies dhe të nxënësve, të cilat nxisin zhvillimin akademik, emocional dhe social të të gjithë nxënësve.

Vijmësia	Drejtori siguron kushte për një proces mësimor të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshëm, si dhe krijon një kulturë të vazhdueshme të zhvillimit profesional.	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, në përputhje me veçoritë kryesore të grupmoshave të nxënësve, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënësve në shkallë e nivele të ndryshme arsimore, duke qartësuar nxënësit dhe prindërit.	Arritjet dhe progresi i nxënësve në të nxënë bëhen duke i ndërtuar njohuritë e reja, mbi bazën e njohurive dhe përvojës së tyre të mëparshme.	Shkolla u mundëson nxënësve kalimin në nivele të ndryshme, duke u dhënë mbështetje emocionale, sociale dhe akademike, për rritjen e potencialit të tyre.
Bashkëpunimi dhe partneriteti	Drejtori ndërton partneritetin shkollë-familje-komunitet, si një mekanizëm i rëndësishëm në planifikimet dhe vendimmarrjet e shkollës.	Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke bashkëpunuar me përgjegjësi me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara.	Shkolla mundëson bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara, për të rritur progresin e nxënësve.	Shkolla bashkëpunon me të gjitha palët e interesuara për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve fizike dhe mësimore, duke promovuar mirëqenien e çdo nxënësi.
Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, përgjegjshmëria	Drejtori realizon përparësitë e shkollës në përmbushje të nevojave dhe interesave të të gjithë nxënësve, duke përdorur në mënyrë efektive të gjitha burimet e saj.	Mësuesit sigurojnë një mësimdhënie të individualizuar, në përshatje të nevojave të të gjithë nxënësve me kurrikulën, për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave themelore.	Nxënësit angazhohen në aktivitete ekstrakurrikulare, të cilat ndikojnë në procesin e nxënies dhe rritjen e nivelit të arritjeve të tyre.	Shkolla u mundëson të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari të ndryshme, sipas nevojave dhe interesave të tyre.

II.5. Treguesit e cilësisë

Treguesit arsimorë janë përkufizuar në përgjithësi, si statistikë e lidhur me politikën që synon të sigurojë informacion rreth kushtit, funksionimit ose veprimtarisë së një sistemi arsimor ose të një pjese të tij, por ata nuk janë dukuri në vetvete. Treguesit arsimorë në nivel shkolle përdoren për këto qëllime:

- sigurojnë një bazë për monitorimin e veprimtarisë së shkollës;
- sigurojnë informacion për arritjet dhe meritat e shkollës;
- sigurojnë informacion për të kuptuar natyrën e problemeve të shkollës;
- sigurojnë informacion për të marrë vendime të ndryshme pedagogjike;
- sigurojnë informacion për të vlerësuar cilësinë e shkollës;
- sigurojnë informacion për të përmirësuar veprimtarinë e shkollës.

Për të përmbushur këto qëllime, duhet të shqyrtohet një gamë e gjerë çështjesh dhe aspektesh që lidhen me vizionin e shkollës, të filozofisë së saj pedagogjike, të karakteristikave të nxënësve, të cilësisë së mësuesve, të shumëllojshmërisë së programeve të saj mësimore dhe edukative, të burimeve fizike, të atmosferës dhe mjedisit social, të arritjeve arsimore e shumë të tjera.

Treguesit e cilësisë janë fjali pohuese të pritshmërisë së performancës së shkollës, në kuadër të kritereve të cilësisë të fushës përkatëse. Treguesit na ndihmojnë për të konstatuar nivelin e cilësisë së shkollës në raport me pritshmëritë. Treguesit e cilësisë janë një sistem i treguesve *sasiorë* dhe *cilësorë*, që përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e arsimit në nivele të ndryshme.

Qëllimi i këtyre treguesve është të karakterizojnë natyrën e sistemit, nëpërmjet komponentëve të tij, si janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe si ndryshojnë në kohë. Ky informacion përdoret pastaj, për të gjykuar progresin përkundrejt një pikë referimi, kundrejt së cilës mund të gjykohej. Në mënyrë ideale, një sistem treguesish mat komponentët e veçantë të sistemit dhe gjithashtu, siguron informacionin, se si komponentët veprojnë së bashku për të prodhuar efektin e përgjithshëm.

Pra, i gjithë informacioni i siguruar nga sistemi i treguesve është më i madh, sesa shuma e pjesëve të tij. Një gjykim i saktë dhe i drejtë sigurohet vetëm, duke përdorur sistemin e treguesve (sasiorë dhe cilësorë) dhe jo tregues të veçuar për vlerësimin e performancës së shkollës.

Përshkruesit praktikë (treguesit specifikë) janë fjali përshkruese për vëzhgimin në praktikë të procesit të vlerësimit. Ata përcaktojnë se si është hartuar, zbatuar dhe si është zhvilluar treguesi i cilësisë. Nëpërmjet përshkruesve praktikë mbledhen informacione dhe të dhëna në shkollë për të vlerësuar treguesit.

Tabela 4: Kriteret dhe treguesit e cilësisë për fushën “Drejtimi dhe menaxhimi”

Kriteret e cilësisë	Treguesit e cilësisë
<p>Drejtori udhëheq planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e përparësive të shkollës, në funksion të zhvillimit të kompetencave themelore, që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit.</p>	<p>1. Drejtori, në bashkëpunim me grupet e interesit, ka siguruar një vizion për shkollën në përputhje me politikat arsimore.</p>
<p>Drejtori siguron përfshirjen e gjithë aktorëve të interesuar në jetën e shkollës, për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p>	<p>2. Drejtori ka shndërruar në një kulturë të vijueshme procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës me të gjithë aktorët e shkollës, për përmirësimin e vazhdueshëm të saj.</p>
<p>Drejtori menaxhon situatat komplekse në mënyrë të barabartë, të drejtë e të paanshme, duke promovuar përgjegjësinë profesionale dhe llogaridhënien.</p>	<p>3. Drejtori ka drejtuar hartimin e rregullores së brendshme, për funksionimin e shkollës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.</p>
<p>Drejtori siguron kushte për një proces mësimor të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshëm, si dhe krijon një kulturë të vazhdueshme të zhvillimit profesional.</p>	<p>4. Drejtori menaxhon në mënyrë efektive burimet njerëzore, për të ofruar një shërbim profesional në përmbushje të qëllimeve të shkollës.</p>
<p>Drejtori ndërton partneritetin shkollë-familje-komunitet, si një mekanizëm i rëndësishëm në planifikimet dhe vendimmarrjet e shkollës.</p>	<p>5. Drejtori menaxhon burimet financiare në mënyrë efektive dhe transparente për të mbështetur përparësitë kyçe.</p>
<p>Drejtori realizon përparësitë e shkollës në përmbushje të nevojave dhe interesave të të gjithë nxënësve, duke përdorur në mënyrë efikase të gjitha burimet e saj.</p>	<p>6. Drejtori siguron zhvillimin e kurrikulës së zbatuar në shkollë, mbështetur në kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës, për të përmbushur aspiratat e nxënësve, të mësuesve, të prindërve dhe të komunitetit.</p>
	<p>7. Drejtuesit e shkollës vlerësojnë arritjet e nxënësve, të stafit dhe të ekipeve të ndryshme, duke promovuar në mënyrë të vazhdueshme standarde të larta.</p>
	<p>8. Drejtori siguron transparencën e arritjeve të shkollës për prindërit e komunitetin, nëpërmjet plotësimit të saktë të Kartës së Performancës.</p>
	<p>9. Drejtori mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit pedagogjik, në funksion të përmirësimit të zbatimit të kurrikulës, të mësimdhënies dhe të të nxënësve të suksesshëm.</p>
	<p>10. Drejtori ndërton marrëdhënie të ndërsjella partneriteti mes shkollës dhe komunitetit, për edukimin cilësor të të gjithë nxënësve.</p>
	<p>11. Drejtori ka ngritur organizmat e shkollës, për ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm.</p>
	<p>12. Drejtori administron dokumentacionin shkollor në ruajtje të përhershme/të përkohshme dhe bazën materiale, në përputhje me aktet/rregulloret përkatëse.</p>

Tabela 5: Kriteret dhe treguesit e cilësisë për fushën “Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit”

Kriteret e cilësisë	Treguesit e cilësisë
<p>Mësuesit sigurojnë mundësi të barabarta arsimi për të gjithë nxënësit, duke realizuar një mësimdhënie dhe nxënie konstruktive, kontekstuale, bashkëvepruese dhe të vetënormuar, në situata dhe kontekste mësimore ose jetësore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi lëndor është hartuar bazuar në dokumentet kurrikulare, në pikëpamjen pedagogjike të mësuesit dhe në përshtatje me nxënësit e tij. 2. Mësuesi realizon bashkë me nxënësit projekte lëndore, ndër-lëndore që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat kurrikulare/ndërkurrikulare. 3. Plani ditor hartohet, duke identifikuar objektin/et e të nxënit dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësit. 4. Mjedisi i të nxënit është funksional dhe motivues për të gjithë nxënësit. 5. Mësuesi dhe nxënësit përdorin një metodologji të përshtatshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave. 6. Mësuesi planifikon detyra shtëpie individuale dhe në grup, si vazhdim i procesit të nxënies. 7. Mësuesi realizon vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të demonstruara nga nxënësit në kontekste të ndryshme.
<p>Mësuesit në planifikimin, zbatimin dhe përvetësimin e kurrikulës, bazohen në nevojat vetjake, stilet e të nxënit dhe përvojat mësimore paraprake të të gjithë nxënësve, për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre.</p>	
<p>Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke siguruar baraspeshën mes njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, për përvetësimin e saj nga të gjithë nxënësit.</p>	
<p>Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, në përputhje me veçoritë kryesore të grupmohave të nxënësve, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë e nivele të ndryshme arsimore, duke qartësuar nxënësit dhe prindërit.</p>	
<p>Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë kurrikulën, duke bashkëpunuar me përgjegjësi me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara.</p>	
<p>Mësuesit sigurojnë një mësimdhënie të individualizuar, në përshtatje të nevojave të të gjithë nxënësve me kurrikulën, për ndërtimin e zhvillimin e kompetencave themelore.</p>	

Tabela 6: Kriteret dhe treguesit e cilësisë për fushën “Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve”

Kriteret e cilësisë	Treguesit e cilësisë
<p>Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore, plotëson pritshmëritë e vendosura në kurrikulën bërthamë.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mësuesi vlerëson vazhdimisht progresin e nxënësit. 2. Mësuesi vlerëson nxënësin duke u bazuar te portofoli i tij.
<p>Shkolla siguron kushte, në mënyrë që nxënësit të nxënë dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 3. Mësuesi mat nivelin e arritjeve të nxënësit me anë të testeve/detyrave përmbledhëse. 4. Mësuesi bën vlerësimin periodik të nxënësit në fund të çdo periudhe.
<p>Arritjet dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve për fushat kurrikulare, ruan baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 5. Mësuesi kryen vlerësimin vjetor dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësit. 6. Mësuesi informon prindërit për rezultatet e nxënësve. 7. Shkolla kryen rivlerësimin e nxënësve.
<p>Arritjet dhe progresi i nxënësit në të nxënë bëhet duke i ndërtuar njohuritë e reja, mbi bazën e njohurive dhe përvojës së tyre të mëparshme.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 8. Rezultatet e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës së pestë, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla. 9. Rezultatet e nxënësve në Provimet e Lirimit, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla.
<p>Shkolla mundëson bashkëpunim të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara, për të rritur progresin e nxënësve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 10. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore, përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga vetë shkolla.
<p>Nxënësit angazhohen në aktivitete ekstrakurrikulare, të cilat ndikojnë në procesin e nxënies dhe rritjen e nivelit të arritjeve të tyre.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 11. Arritjet e nxënësve përputhen me pritshmëritë e shkollës.

Tabela 7: Kriteret dhe treguesit e cilësisë për fushën “Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve”

Kriteret e cilësisë	Treguesit e cilësisë
<p>Shkolla siguron mjedise mësimore të sigurta, të përshtatshme dhe ftuese, në funksion të zotërimit të kompetencave themelore nga të gjithë nxënësit.</p>	<p>1. Shkolla ofron mjedise fizike dhe mësimore të përshtatshme, që sigurojnë mirëqenien e të gjithë nxënësve.</p>
<p>Shkolla siguron përfshirjen e të gjithë nxënësve në veprimtaritë mësimore- edukative për rritjen e mirëqenies.</p>	<p>2. Shkolla ofron mbështetje emocionale, sociale dhe akademike për të gjithë nxënësit.</p>
<p>Mësuesit sigurojnë strategji të mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat nxisin zhvillimin akademik, emocional dhe social të të gjithë nxënësve.</p>	<p>3. Shkolla mbështet nxënësit me nevoja të veçanta.</p>
<p>Shkolla u mundëson nxënësve kalimin në nivele të ndryshme, duke u dhënë mbështetje emocionale, sociale dhe akademike, për rritjen e potencialit të tyre.</p>	<p>4. Shkolla u garanton nxënësve të drejtat dhe ushtrimin e detyrave të tyre.</p>
<p>Shkolla bashkëpunon me të gjitha palët e interesuara për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve fizike dhe mësimore, duke promovuar mirëqenien e çdo nxënësi.</p>	<p>5. Psikologu/punonjësi social kontribuon për mirëqenien e të gjithë individëve dhe grupeve në shkollë.</p>
<p>Shkolla u mundëson të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari të ndryshme, sipas nevojave dhe interesave të tyre.</p>	<p>6. Oficeri i sigurisë kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj.</p>
	<p>7. Shkolla ndërvepron me prindërit dhe komunitetin për përmirësimin e mirëqenies në shkollë.</p>

II. 6. Shkallët e vlerësimit

Korniza për Vlerësimin e Cilësisë së Shkollës ka përcaktuar shkallën e vlerësimit, në nivel të përshkuesve praktikë, në nivel të treguesve të cilësisë, në nivel të fushave të cilësisë dhe në nivel të përgjithshëm të cilësisë së shkollës.

Shkalla e vlerësimit është një metodë e përdorur për të vlerësuar gjykimin *me shprehje* ose *me numra*, në lidhje me një aspekt, objekt, karakter ose një atribut të veprimtarisë së shkollës. Shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit përbëjnë sistemin që përdoret nga vlerësuesi gjatë vlerësimit të cilësisë, në kushtet reale të shkollës. Nivelet e vlerësimit sipas shkallës numerike, janë 4, përkatësisht: 1, 2, 3, 4, ku niveli 1 i përket shkallës më të ulët dhe niveli 4 shkallës më të lartë. Vlerësimi sipas shkallës së cilësisë, kryhet referuar shprehjeve: shumë mirë, mirë, mjaftueshëm dhe dobët.

Norma e vlerësimit është model standard, që përcakton shkallën e cilësisë sipas nivelit të vlerësimit.

Tabela 8: Shkallët e vlerësimit

Nivelet e vlerësimit	Norma e vlerësimit	Shkallët e cilësisë
4	Ka realizuar nga 90% - 100% të përshkuesve praktikë	Shumë mirë
3	Ka realizuar 75% - 89% të përshkuesve praktikë	Mirë
2	Ka realizuar 51% - 74% të përshkuesve praktikë	Mjaftueshëm
1	Ka realizuar nën 50% të përshkuesve praktikë	Dobët

Më poshtë janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të vlerësimeve, të cilat përdoren gjatë procesit të vlerësimit në shkollë

Përshkruarit praktikë vlerësohen sipas niveleve të vlerësimit: 1, 2, 3, 4.

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas shkallës së cilësisë, në përputhje me normën e vlerësimit të përshkuesve praktikë, përkatësisht:

- *Shumë mirë*: kur shkolla ka realizuar 90%-100% të përshkuesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- *Mirë*: kur shkolla ka realizuar 75%-89% të përshkuesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;
- *Mjaftueshëm*: kur shkolla ka realizuar 51%-74% të përshkuesve praktikë të vlerësuar për atë tregues;

- *Dobët:* kur shkolla ka realizuar nën 50 % të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.

Fushat e cilësisë vlerësohen duke llogaritur mesataren aritmetike të vlerësimit të treguesve të cilësisë të asaj fushe.

Vlerësimi i shkollës kryhet duke llogaritur mesataren aritmetike të vlerësimit të fushave të cilësisë.

Trendi është shkalla e cila përcakton cilësinë e shkollës, që realizohet në rivlerësim apo në vlerësimin periodik të shkollës, duke u mbështetur në krahasimin e vlerësimeve të tjera të kryera në shkollë.

Tabela 9: Trendi i rivlerësimit

TRENDI		PËRSHKRIMI
Niveli	Shkalla	
5	Shkëlqyeshëm	Performanca e shkollës i ka tejkaluar pritshmëritë, duke arritur një cilësi jashtëzakonisht të lartë të punës së kryer në të gjitha fushat. Shkolla ka qëllime/synime të larta për performancën e saj. Ky vlerësim është i arritshëm nga çdo punonjës, megjithëse i dhënë rrallë.
4	Tejkalon pritshmëritë	Performanca shpesh tejkalon pritshmëritë në të gjitha fushat e përgjegjësisë dhe cilësia e punës në përgjithësi, është shumë e mirë. Përparësitë/objektivat vjetorë janë përmbushur.
3	Përmbush pritshmëritë	Performanca është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fushat e përgjegjësisë, brenda afateve të përcaktuara, ndoshta duke tejkaluar pritshmëritë, dhe cilësia e punës në përgjithësi, është shumë e mirë. Përparësitë/objektivat vjetorë më të rëndësishëm janë përmbushur.
2	Përmirësim i nevojshëm	Performanca e shkollës nuk përputhet në mënyrë të vazhdueshme me pritshmëritë. Performanca nuk ka arritur të përmbushë një ose më shumë nga përparësitë/objektivat e shkollës. Është e nevojshme të hartohet një plan zhvillimi profesional për të përmirësuar performancën, duke përcaktuar afatet kohore dhe duke monitoruar në vijimësi matjen e progresit.
1	I pakënaqshëm	Performanca vazhdon të jetë nën pritshmëritë, në fushat më të rëndësishme të përgjegjësisë, dhe nuk vihet re asnjë progres drejt përparësive. Është i domosdoshëm përmirësimi i menjëhershëm në një ose më shumë fusha të rëndësishme. Nevojitet një plan urgjent për të rritur performancën, duke përfshirë afatet kohore, si dhe duhet të monitorohet në vijimësi matja e progresit.

BAZA LIGJORE:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
4. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
5. Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020.
6. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2014.

BIBLIOGRAFIA:

- Agency for the Development of Quality in Schools (ADQS), Evaluation and assessment frameworks for improving school outcomes, 2012, marrë në qershor 2019, nga <https://www.oecd.org/education/school/46927511.pdf>.
- Australian Government, Department of Education, Employment and öorkplace Relations, OECD Review on Evaluation and Assessment Frameworks for Improving School Outcomes, Australia 2010, marrë në qershor 2019 nga <http://www.oecd.org/education/school/48523989.pdf>.
- Eurodice Report, *Assuring Quality in Education/ Policies and Aproaches in Europe*. 2015, marrë në qershor 2019, nga https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/assuring-quality-education-policies-and-approaches-school-evaluation-europe_en.
- Gray, A., *European school inspection and evaluation: History and principles*, 2019, marrë në qershor 2019, nga <http://www.sici-inspectorates.eu/news/understanding-the-development-of-school-inspection>.
- IKAP, *Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës*, 2011.
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, *Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë*, 2016, marrë në qershor 2019 nga <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>.
- Inspectorate of Education, *Risk-based inspection as of 2009, Primary and secondary education*, 2010, marrë në qershor 2019, nga <https://english.onderwijsinspectie.nl/documents/annual-reports/2010/05/20/risk-based-inspection-as-of-2009>.
- Johan C. van Bruggen, SICI, *Inspectorates of Education in Europe; some comparative remarks about their tasks and work*, 2010,

<https://www.vet.al/files/ligje%20etj/Inspektimi%20dhe%20vleresimi%20i%20brendshem%20i%20shkolles%20Udhezuesi%20i%20shkolles.pdf>.

- OECD, Curriculum reform: An education change perspective, Dublin, Ireland 2018, marrë në korrik 2019 nga <https://www.ncca.ie/media/3361/dublin-oecd-pont-reforms-02-18-v4.pdf>.
- Ofsted, The education inspection framework, 2019.
- SICI, *How to define and measure output/outcomes of schools? Using student achievement data for school inspections*, Conference in Amsterdam, 2010, marrë në qershor 2019, nga <http://www.sici-inspectorates.eu/>.
- The Standing International Conference of Inspectorates, SICI, *OECD Review on Evaluation and Assessment Frameworks for Improving School Outcomes: the Main Conclusions*, Prague, October 2002, marrë në qershor 2019, nga www.oecd.org/edu/evaluationpolicy.
- UNESCO, Albania/education policy Review: Issues and Recommendations, 2017.